Pjesa B Udhëzime për nxënëset dhe nsënësit si dhe për personat e autorizuar për edukim

Ju merrni pjesë në një nismë, e cila sponsorizohet ndër të tjera me mjete financiare edhe nga Fondi Social Europian (shkurtimi në gjerm. ESF). Autoritetet administrative të ESF-së duhet të informojnë rregullisht Komisionin Europian lidhur me përdorimin e parave. Për këtë arsye atyre u nevojiten informacione të caktuara nga ana juaj. Në pjesën C të pyetësorit do të regjistrohen me miratimin tuaj të dhënat përkatëse kontaktuese. Në pjesën D do të grumbullohen edhe të dhëna të tjera karakteristike.
Enti përgjegjës i një nisme të tillë është i ngarkuar të vjelë nga ju informacionet e nevojshme për këtë gjë. Enti në fjalë është i detyruar t'i respektojë dhe t'i përmbahet rregullave lidhur me mbrojtjen ligjore të të dhënave personale. Në këtë drejtim entet pjesëmarrëse janë udhëzuar në mënyrë të veçantë. Nëse keni pyetje lidhur me udhëzimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen ligjore të të dhënave personale ose me miratimin për deklarimin e tyre (pjesa C), përkatësisht me pyetësorin (pjesa D), ju ndihmon me kënaqësi një bashkëpunëtore ose bashkëpunëtor i entit përgjegjës arsimor.

Udhëzime lidhur me mbrojtjen ligjore të të dhënave personale në kuadrin e sponsorizimit nga Fondi Social Europian (ESF)

1. Përgjegjës për vjeljen e të dhënave personale:

Bayerisches Staatsministerium für Familie, Arbeit und Soziales
Ref. I 2 (Verwaltungsbehörde ESF in Bayern)
Winzererstraße 9
80797 München
E-Mail: esf@stmas.bayern.de
Tel.: 089/1261-1063

2. Të dhënat kontaktuese të personit përgjegjës lidhur me mbrojtjen ligjore të të dhënave personale

Datenschutzbeauftragter im Bayerischen Staatsministerium für Familie, Arbeit und Soziales
Winzererstraße 9
80797 München
E-Mail: Datenschutz@stmas.bayern.de
Tel.: 089/1261-01

3. Synimet dhe baza ligjore e përpunimit:

Oferta e detyrueshme gjithëditore për klasat e gjermanishtes në shkollat fillore dhe të mesme në Bavari sponsorizohet ndër të tjera me mjete financiare edhe nga Fondi Social Europian (ESF). Institucionet bavareze, të cilat janë përgjegjëse për përdorimin e këtyre mjeteve financiare, duhet të informojnë rregullisht Komisionin Europian lidhur me këtë gjë. Për këtë arsye janë të nevojshme informacione të caktuara nga ana e pjesëmarrësve, të cilat do të vilen përmes këtij pyetësori.
Emri, të dhënat kontaktuese dhe ditëlindja e nxënëseve dhe nxënësve pjesëmarrëse/pjesëmarrës (të dhënat personale të detyrueshme) janë të nevojshme, në mënyrë që të dëshmohet zbatimi i rregullt i projekteve të sponsorizuara. Përveç kësaj do regjistrohen dhe informacione që kanë të bëjnë me shkallën e arsimimit, me situatën profesionale si dhe me kuadrin social (të ashtuquajturit indikatorë). Përmes një kodi Indikatorët do të memorizohen veç nga të dhënat personale të detyrueshme (duke përdorur një pseudonim), por ky kod mund t'i bashkangjiten në kushte të caktuara përsëri të dhënave personale.
Kjo gjë mund të ndodhë vetëm atëherë kur bëhet verifikimi i përdorimit të mjeteve financiare të vëna në dispozicion nga BE, në rastin e një shtese të këtyre mjeteve ose në kuadrin e vlerësimit të punës së bërë.

Përpunimi i të dhënave bëhet mbi bazën e nen. 6, paragr. 1, gërm. a) dhe c) të rregullores (BE) 2016/679 (Rregullorja bazë për mbrojtjen ligjore të të dhënave personale), në lidhje me nen. 5 të rregullores nr. 1304/ 2013, në lidhje me nen. 27, paragr. 4 dhe nen. 96, paragr. 2b, shifr. ii, iv të rregullores (BE) nr. 1303/2013.

4. Marrës ose kategori të marrësve lidhur me të dhënat përkatëse të personave:

Institucioneve të mëposhtme u krijohet mundësia që të kenë informacione lidhur me të dhënat personale të detyrueshme dhe indikatorët përkatës:

- Entit përgjegjës në kuadër të të dhënave që ai ka vjelë për nismën në fjalë,
- Institutit për Kërkime Sociale dhe Politikë Shoqërore shpk (shkurtimi në gjerm. ISG), vetëm në rast se do të bëjë vlerësimin e punës së bërë (mundësia e kontaktimit: ISG: Instituti për Kërkime Sociale dhe Politikë Shoqërore shpk, Weinsbergstraße 190, 50825 Köln, info@isg-institut.de),
- shërbimit informatik përgjegjës për organizimin kompjuterik të të dhënave PASS IT-Consulting (mundësia e kontaktimit: PASS IT-Consulting, informaticien i dipl. G. Rienecker shpk & Co. shk, Schwalbenrainweg 24, 63741 Aschaffenburg, info@pass-consulting.com),
- Gjykatës së Lartë Bavareze të Llogarive , Gjykatës Europiane të Llogarive, institucioneve përgjegjëse të Komisionit Europian si dhe autoriteteve verifikuese të ESF-së në Bavari, mbi bazën e një kërkese dhe në kuadrin e përmbushjes së kompetencave të tyre verifikuese.

Kombinimi i të dhënave të detyrueshme personale me indikatorët është i lejueshëm vetëm për verifikime që janë detyrimisht të nevojshme, p.sh. në rastin e shtesës së mjeteve financiare për raportime të detyrueshme të parashikuara me ligj dhe për vlerësime shkencore të punës së bërë. I paprekur mbetet në këtë drejtim verifikimi i mundësisë për t'u përkrahur nga ana e pjesëmarrësve (p.sh. lidhur me aspekte të tilla si mosha, gjinia ose vendi i banimit apo i punës).

Institucioneve të mëposhtme u krijohet mundësia që të kenë informacione vetëm pjesërisht lidhur me të dhënat personale të detyrueshme (mënyra e të drejtuarit, emri, mbiemri, datat fillestare dhe përmbyllëse të nismës) dhe për indikatorët përkatës vetëm si shumë:

- autoriteteve miratuese të ESF-së pranë Qeverisë së Bavarisë së Poshtme (mundësia e kontaktimit: Qeveria e Bavarisë së Poshtme, Sg. 13, Regierungsplatz 540, 84028 Landshut, poststelle@reg-nb.bayern.de),
- dikasterit përgjegjës në Ministrinë Shtetërore Bavareze për Arsim dhe Kulturë (mundësia e kontaktimit: Salvatorstr. 2, 80333 München, poststelle@stmbw.bayern.de),
- dikastereve përgjegjëse në Ministrinë Shtetërore Bavareze për Familje, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pra konkretisht autoriteteve administrative të ESF-së në Bavari, autoriteteve kontrolluese të ESF-së në Bavari si dhe autoriteteve certifikuese të ESF-së në Bavari (mundësia e kontaktimit: Ministria Shtetërore Bavareze për Familje, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Winzererstraße 9, 80797 München, esf@stmas.bayern.de)

Të gjitha institucionet e tjera të cilat janë të angazhuara me vënien në përdorim të ndihmës financiare të ESF-së kanë mundësinë t'i shikojnë të dhënat e grumbulluara vetëm të anonimizuara.

5. Pyetjet

Përmes deklaratës miratuese mundësohet dhënia e përgjigjeve të detyrueshme lidhur me emrin, të dhënat kontaktuese dhe ditëlindjen.

Nxënësja ose nxënësi merr **në fillim të vitit shkollor** një pyetësor në të cilin kërkohen disa të dhëna lidhur me prejardhjen, kuadrin shoqëror dhe diskriminimet eventuale që mund të rrjedhin prej tyre. Për plotësimin e pyetësorit janë në dispozicion për ndihmë mësuesja/mësuesi në marrëdhënie pune, përkatësisht personeli pedagogjik. Direkt pas përfundimit të ofertës së detyrueshme gjithëditore në kuadrin e një klase për gjermanisht do të pyetet dhe enti përgjegjës për shpenzimet e shkollës në lidhje me situatën shkollore dhe profesionale të nxënëses apo nxënësit. Në dhënien e përgjigjeve ky ent do të ketë në ndihmë shkollën.

Për të pasur mundësinë e informimit lidhur me situatën profesionale dhe shoqërore **gjashtë muaj** pas përfundimit të nismës në fjalë ISG (Instituti për Kërkime Sociale dhe Politikë Shoqërore shpk, shkurtimi në gjerm. ISG) kontakton nxënëse ose nxënës të veçanta/ë që kanë marrë pjesë në ofertat e detyrueshme për klasat e gjermanishtes. Përmes

pyetjeve që u bëhen atyre pas përfundimit të përkujdesjes gjithëditore në kuadrin e klasave të gjermanishtes mundësohet njohja dhe vlerësimi i suksesit të projektit.

Në adresën: www.km.bayern.de/esf ju mund t'i shikoni pyetësorët online.

6. Kohëzgjatja e memorizimit të të dhënave personale

Pas vjeljes datat tuaja do të ruhen të memorizuara në shërbimin kompjuterik PASS IT-Consulting, të autorizuar nga Ministria Shtetërore Bavareze për Familje, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për aq kohë sa parashikohet nga baza ligjore e respektimit të afateve për përmbushjen e nismës në fjalë, sipas nenit 140, paragr. 1 të rregullores (BE) Nr. 1303/2013. Sipas njohurive të deritanishme ky memorizim parashikohet të ruhet deri më 31.12.2018.

7. Të drejtat e personave pjesëmarrës

Sipas rregullores (BE) 2016/679 (Rregullorja bazë për mbrojtjen ligjore të të dhënave personale) ju keni të drejtë:

- Neni 15: Të informoheni për të dhënat tuaja personale të memorizuara, në rast se ato do përpunohen më tej.
- Neni 16: Të bëni saktësimin e tyre, nëse të dhënat tuaja personale janë përpunuar në mënyrë jo të saktë.
- Nenet 17, 18 dhe 21: Të kërkoni fshirjen, kufizimin e përpunimit të të dhënave si dhe të bëni ankesë lidhur me përpunimin e të dhënave, nëse përmbushen kushtet ligjore për këtë gjë.
- Neni 20: Të transferoni të dhënat tuaja, nëse keni dhënë miratimin për përpunimin e të dhënave ose në rast se keni lidhur një kontratë për përpunimin e tyre dhe ky përpunim bëhet përmes procedurave të automatizuara.

Nëse ju pretendoni të vini në zbatim ndonjërën nga të drejtat e mësipërme, atëherë institucioni publik do të verifikojë në rastin konkret, nëse janë përmbushur kushtet ligjore për këtë gjë. Përveç kësaj ekziston dhe e drejta ankimore pranë të autorizuarit të Landit Bavarez lidhur me mbrojtjen ligjore të të dhënave personale.

8. E drejta e revokimit lidhur me miratimin

Nëse në përpunimin e „të dhënave personale veçanërisht delikate" të vjela në pjesën D2 ju i keni dhënë Ministrisë Shtetërore Bavareze për Familje, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratimin tuaj përkatës lidhur me invaliditete fizike që mund të keni, me kuadrin emigrues ose me diskriminime të tjera, keni mundësinë në çdo kohë në të ardhmen ta merrni mbrapsht këtë miratim. Kuadri ligjor mbi të cilin bazohet miratimi mbetet i paprekur deri në momentin e tërheqjes së përpunimit vijues të të dhënave dhe nuk ndikohet nga ky i fundit.

9. Detyrimi për vënien në dispozicion të të dhënave

Ju merrni pjesë në një nismë, e cila sponsorizohet ndër të tjera me mjete financiare edhe nga Fondi Social Europian (shkurtimi në gjerm. ESF). Përdorimi korrekt i mjeteve financiare duhet t'i dëshmohet dhe t'i informohet Komisionit Europian. Përgjegjëse për këtë gjë janë autoritetet administrative të ESF-së pranë Ministrisë Shtetërore Bavareze për Familje, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Autoritetet administrative të ESF-së duhet t'i raportojnë rregullisht Komisionit Europian. Ky raportim përmban edhe të dhënat mbi pjesëmarrësit (nen. 5 rregullorja (BE) Nr. 1304/2013 në lidhje me nen. 27, paragr. 4 dhe nen. 96 paragr. 2b shifr. ii, iv rregullorja (BE) Nr. 1303/2013). Nëse Bavaria nuk i dërgon raportet e kërkuara Komisionit Europian ose dërgon të tilla me gabime, atëherë ky i fundit mund të pengojë pagesën e parave. Kjo gjë do të prekte natyrisht edhe nismën tuaj në fjalë. Për këtë arsye mund të përkrahen vetëm ata persona, për të cilët janë grumbulluar të dhënat e nevojshme personale.

Një pjesëmarrje në një ofertë të detyrueshme gjithëditore për klasat e gjermanishtes është **vetëm atëherë e mundur**, nëse nxënëset, përkatësisht nxënësit

- paraqesin një deklaratë miratuese të plotësuar me të dhënat e detyrueshme personale dhe të nënshkruar; për nxënëset dhe nxënësit që janë nën 18 vjeç, nënshkruajnë prindërit ose personat e autorizuar për edukim;
- japin informacion për të dhënat e detyrueshme që kërkohen në pyetësorin D („Pyetësor për nxënëset dhe nxënësit"). Jo të detyrueshme janë të dhënat që kërkohen lidhur me sfondin emigrues, me invaliditete fizike ose diskriminime të tjera. Për të dhëna të tilla mund të mos jepet përgjigje; në pyetësor është parashikuar për këtë rast një fushë me shenjimin „nuk jepen të dhëna".